

---

**AKT THEMELIMI**

**i**

**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**EGYAL Sh.p.k.**

**TIRANË, 2021**

## Neni 1

### Emri

- 1.1 Sot, më datë 07.07.2021 krijohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, emri i së cilës është **EGYAL Sh.p.k**, në vijim e referuar shkurt si "**Shoqëria**". Emri tregtar i shoqërisë është **EGYAL**.

## Neni 2

### Themelimi.

- 2.1 Shoqëria themelohet bazuar në legjislacionin shqiptarë në fuqi dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar, me këtë Akt Themelimi dhe me Statutin e saj.

## Neni 3

### Selia

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga "Jordan Misja ", Njd Nr 9, Tirane Shqiperi.
- 3.2 Shoqëria mund të hapë dhe mbajë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme përveç selisë së Shoqërisë brenda territorit shqiptar.

## Neni 4

### Ortakët e Shoqërisë

- 4.1 Ortakët dhe themeluesit e Shoqërisë janë:
1. **Z.Ivan Nagy Kamel ABDELSAID**, shtetas Anglez lindur me 08-Qer-1987 identifikuar me pasaporte Nr. 127090441 zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkruara në shumën prej **950 LEKE** (*nenteqind e pesedhjet*), të cilat përfaqësojnë **95 %** të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
  2. **Znj.Naheed Lofty Marcos Hana**, shtetase Egjiptiane lindur me 11.12.1962 ne Egypt identifikuar me pasaporte Nr. A23875213, zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkruara në shumën prej **50 LEKE** (pesedhjet ), të cilat përfaqësojnë **5 %** të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

## Neni 5

### Kapitali Themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën **1.000 Lekë** (*njemije*), i ndarë në **2 (dy) kuota**, me vlerë sipas nenit 4 me sipër.
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para, plotësisht të nënshkruara dhe paguara dhe zotërohet nga ortakët e Shoqërisë sipas Nenit 4 të këtij Akti Themelimi.

- 5.3 Kuotat, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe pas ushtrimit të së drejtës së parablerjes ndaj ortakëve të tjerë të Shoqërisë sipas parashikimeve statutore, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër dhe forme të parashikuar nga ligji dhe/ose statutit.

## **Neni 6 Objekti**

- 6.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin si më poshtë vijon: “Shërbime Turistike , Agjenci Turistike , Menaxhim Hotelesh Shërbime në airbnb, Shërbime Akomodimi nëpër Hotele , Guest House , Shtëpi pushimi , Fshatra Turistik. Agjenci imobiliare (Real Estate) , duke përfshirë por pa u kufizuar në: shitje , blerje , dhënie me qira dhe zhvillim të pasurive të paluajtshme etje”. Shërbime Konsulence Online , Marketing, Automjete me Qira , mësimdhënie të gjuhës egjiptiane , Angleze , Kurse edukative shkollore dhe jashtë shkollore “etje.

## **Neni 7 Kohëzgjatja**

- 7.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## **Neni 8 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**

- 8.1 Asembleja e Përgjithshme, në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marrë, por pa u kufizuar në, vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit/ëve kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit, etj sikurse parashikohet në Statut dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.

## **Neni 9 Administrimi i Shoqërisë**

- 9.1 Administratori/ët e parë të Shoqërisë janë:

**Znj.Naheed Lofty Marcos Hana**, shtetase Egjiptiane lindur me 11.12.1962 ne Egypt identifikuar me pasaporte Nr. A23875213, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar.

- 9.2 Administratori/ët emërohen për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi. Administratorët emërohen dhe/ose shkarkohen nga detyra, në çdo kohë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.

**Neni 10**  
**Ligji i Zbatueshëm**

- 10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 10.2 Çdo konflikt që mund të lindë mes ortakëve të Shoqërisë në lidhje me, ose si rrjedhojë e këtij akti themelimi do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**ORTAKET THEMELUES**



**Z.Ivan Nagy Kamel ABDELSAID**



**Mrs. Naheed Lofty Narcos Hana**